



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 17 shkronja h) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 35.5 të Ligjit nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikës e Kosovës, nenin 18 paragrafët 1, 2.2 dhe 3 të Rregullores (QRK) Nr. 19/2024 Për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo – Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar si dhe nenet 16, 19 parag. 1.8 dhe 61 parag.1.3 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, në propozim të Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit, nr. prot. 02-111/01-0012791/25, datë 28.02. 2025, nxjerrë këtë;

VENDIM

PËR EMËRIMIN E PËRKOHSHËM NË POZITËN E DREJTORIT TË SHKOLLËS FILLORE TË MESME TË ULËT - SHFMU “NUHI GASHI” NË FSHATIN BRADASH KOMUNA E PODUJEVËS

Neni 1

 me nr. personal të letërnjoftimit  nga fshati Bradash, Komuna e Podujevës, i kualifikuar Batchelor i Gjuhës Angleze- Kolegji AAB,

Emërohet përkohësisht në pozitën e Drejtorit në SHFMU “ Nuhi Gashi” në fshatin Bradash, Komuna e Podujevës.

Neni 2

I përmenduri sipas nenit 1 të këtij vendimi emërohet përkohësisht deri në zgjedhjen/emërimin e Drejtorit/eshës sipas procedurës së rregullt të konkursit apo deri në një akt tjetër administrativ.

Neni 3

Kushtet e punës, të drejtat, përgjegjësitë dhe paga mujore caktohen me kontratën e punës.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Neni 5

Zbatimin e vendimit dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me këtë vendim e bën Drejtoria e Arsimit.

*I dërgohet:
Drejtorisë së Arsimit
Të emëruarit
QSHQ/Arkivit*

Nr. prot. 02-016/01-0013043/25
Podujevë, datë: 03.03.2025





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 17 shkronja h) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 35.5 të Ligjit nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikës e Kosovës, nenin 18 paragrafët 1, 2.2 dhe 3 të Rregullores (QRK) Nr. 19/2024 Për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendës drejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo – Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar si dhe nenet 16, 19 parag. 1.8 dhe 61 parag.1.3 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, në propozim të Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit, nr. prot. 02-111/01-0012798/25, datë 28.02. 2025, nxjerrë këtë;

VENDIM

PËR EMËRIMIN E PËRKOHSHËM NË POZITËN E DREJTORIT / ESHËS TË SHKOLLËS FILLORE TË MESME TË ULËT - SHFMU “ALI HADRI” NË FSHATIN OBRANÇË KOMUNA E PODUJEVËS

Neni 1

, me nr. personal të letërnjoftimit  nga Podujeva, e kualifikuar Fakulteti Filozofik-Prof. i Pedagogjisë,

Emërohet përkohësisht në pozitën e Drejtoreshës në SHFMU “Ali Hadri” në fshatin Obrançë, Komuna e Podujevës.

Neni 2

E përmendura sipas nenit 1 të këtij vendimi emërohet përkohësisht deri në zgjedhjen/emërimin e Drejtorit/eshës sipas procedurës së rregullt të konkursit apo deri në një akt tjetër administrativ.

Neni 3

Kushtet e punës, të drejtat, përgjegjësitë dhe paga mujore caktohen me kontratën e punës.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Neni 5

Zbatimin e vendimit dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me këtë vendim e bën Drejtoria e Arsimit.

*I dërgohet:
Drejtorisë së Arsimit
Të emëruarës
QSHQ/Arkivit*

Nr. prot. 02-016/01-0013 044/25
Podujevë, datë: 03.03.2025

**Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi**





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, Rregulloren MF – Nr. – 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenet 16 dhe 61 parag.1.2 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, në kërkesë të Drejtoreshës së Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale nr. prot. 02-400/03-0012800/25, datë 28.02.2025, nxjerr:

V E N D I M

Për shpalljen e thirrjes publike për mbështetje financiare publike për projektet/programet e OJQ-ve

Neni 1

1.Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e Rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

2.Mbështetja financiare publike e OJQ-ve, për projekte/programme dedikuar personave me nevoja të veçanta, ofrohet nga Buxheti i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, kodi ekonomik 21200, në kuadër të programit 73014.

Neni 2

Mjetet financiare shpërndahen në bazë të thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 3

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II të këtij vendimi përfshinë:

- 1.1. Teksti i thirrjes publike
- 1.2. Udhëzimet për aplikantët
- 1.3. Formularët e aplikimit
- 1.4. Forma për vlerësimin e cilësisë së projekteve
- 1.5. Format për raportimin e zbatimit të projektit

2. Formularët e aplikimit referuar në paragrafin 1 të këtij neni janë:

- 2.1. Forma e përshkrimit të programit apo projektit
- 2.2. Forma e buxhetit të programit apo projektit
- 2.3. Forma e deklarimit të mungesës së fondeve të dyfishta
- 2.4. Deklarata e Partneritetit(nëse është e aplikueshme)
- 2.5 Forma e deklaratës së programeve/projekteve të OJQ-ve të financuara nga burimet

publike

- 2.6 Deklarata për aktivitetet e kontraktorit e përmendur në përshkrimin e aktiviteteve të projektit që janë të njohur e programin /projektin dhe pjesëmarrjen e tyre në zbatimin (nëse aplikohet)
3. Formularët për zbatimin dhe raportimin e projekteve të referuara në paragrafin 1 të këtij neni janë:
- 3.1 Forma e kontratës për financimin e programit/projektit
- 3.2 Formulari për përgatitjen e raportit narrativ për projektin/programin
- 3.3 Formulari për përgatitjen e raportit financiar të programit/projektit

Neni 4

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të Komunës së Podujevës <https://kk.rks-gov.net/podujeve/>

Neni 5

1. Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, do të formohet Komisioni Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.
2. Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranura që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.
3. Komisioni Vlerësues punët dhe detyrat do t'i ushtrojnë në përputhje me rregullat e parapara me Rregulloren për financimin publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

Neni 6

1. Përfituesit me projekt/programet e tyre do të njoftohen për kohën e nënshkrimit të kontratave
2. Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 7

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot. 02-420/03-0013409/25
Podujevë, datë: 04.03.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronjat b) dhe i) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafët 1.2 dhe 1.9, të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafët 3.1 dhe 3.2 të Rregullores Komunale për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot. 01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0017955/24 të datës 14.03.2024, i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr.prot.02-020/04-0063865/24, të datës 20.09.2024, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione merr;

VENDIM

PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PERSONAVE ME GJENDJE TË RËNDË SHËNDETËSORE DHE SOCIALE

Neni 1

Me këtë vendim lejohet dhënia e ndihmës financiare në shumë të përgjithshme prej 20,600.00€, ndihmë për njëqindëdhjetë (110) persona me gjendje të rëndë shëndetësore dhe ekonomike - sociale për muajin shkurt 2025, sipas shumave individuale të paraqitura në listën e rekomanduar nga komisioni përkatës.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 3

Shuma e mjeteve individuale sipas listës bashkangjitur këtij vendimi nuk tejkalon shumën e mjeteve financiare sipas Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022.

Neni 4

Lista e përfituesve të ndihmës financiare është pjesë përbërëse e Vendimit.

Neni 5

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot 02-460/04-0016065/25
Podujevë, datë 06. 03. 2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-02/01-0050862/18, nenet 8, 11.1 dhe 22 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, Vendimin nr.prot.01-401/01-0065086/24, të datës 26.09.2024, Për Miratimin e Projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2025 dhe Parashikimet Buxhetore 2026-2027, në implementimin e projektit "Përkrahja me Feferona", në rekomandim të Komisionit Ad-Hoc të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0008686/25 të datës 06.02.2025, për shqyrtimin edhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve sipas Ftesës Publike nr.12-320/01-0003670/25, të datës 16.01.2025, Kryetari i Komunës, merr:

V E N D I M

Neni 1

1. Lejohen mjete financiare për subvencionimin e 15 (pesëmbëdhjetë) fermerëve përfitues të Komunës së Podujevës për kultivimin e feferonave.

2. Mbështetja e fermerëve do të bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Ftesën publike "*Përkrahje me Feferona*", përkatësisht në vlerën prej 700 € për sipërfaqen prej 20 ari me perimkulturë-feferona si vlerë maksimale e mbështetjes për një fermer/e.

Neni 2

Qëllim i realizimit të këtij projekti është promovimi dhe zhvillimi i bujqësisë në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 3

Lista e aplikuesve të përzgjedhur për implementimin e projektit: "*Përkrahje me Feferona*", sipas nenit 1 është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e Vendimit kujdeset Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, i cili do të bëjë verifikimin, konstatimin dhe vlerësimin e përmbushjes së kushteve dhe kriterëve nga ana e fermerit/es si dhe çështjeve tjera të parapara sipas ftesës publike përkatëse.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. prot. 02-400/04-0014099/25
Podujevë, datë 06.03.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Buliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenit 16 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës nr. prot.01-020/01-50862/18 dhe nenit 7 paragrafi 6, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, nr.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, merr:

V E N D I M

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË VEÇANTË PËR RASTET DHE KËRKESAT INDIVIDUALE PËR NDARJE TË SUBVENCIONEVE

Neni 1

Për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve për rastet dhe kërkesat individuale të cilat paraqiten jashtë thirrjeve publike, ngritet Komisioni në këtë përbërje:

Rilind Babatinca,	kryesues - <i>Drejtoria e Buxhetit dhe Financave</i>
Blerim Vllasa,	anëtar - <i>Drejtoria e Arsimit</i>
Shefrie Gashi,	anëtare - <i>Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural</i>
Arbresha Bashota	anëtare - <i>Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale</i>
Naxhie Hasani	anëtare - <i>Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale</i>

Neni 2

Komisioni punët, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në pajtim me Rregulloren nr.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022 për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, ndërsa shfuqizohet vendimi nr. prot 02-020/04-0017955/24 i datës 14.03.2024 me plotësim ndryshimet e bëra.

U dërgohet:
Anëtarëve të komisionit
Drejtorive përkatëse
QSHQ/Arkivit

Nr. Prot 02-020/04-0014132/25
Podujevë, datë 07.03.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 dhe 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, në pajtim me nenin 12 të Rregullores MF - Nr – 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, në kërkesë nr.02-400/03-0014166/25 të datës 07.03.2025 të Drejtorit të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, merr:

V E N D I M

PËR SHPALLJEN E THIRRJES PUBLIKE PËR MBËSHTETJE FINANCIARE PUBLIKE TË OJQ-VE PËR VITIN 2025 PËR PROJEKTET NË FUSHËN E KULTURËS DHE RINISË NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

1.Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e Rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

2.Mbështetja financiare publike për projektet/programet e OJQ-ve në Komunën e Podujevës bëhet për projektet në fushën e kulturës dhe rinisë nga buxheti i Komunës së Podujevës, kodi ekonomik 21200, në kuadër të programit/nënprogramit 85142.

Neni 2

Mjetet e financiare shpërndahen në bazë thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, pas vlerësimit dhe përzgjedhjes nga ana e komisionit si dhe dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 3

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II të këtij vendimi përfshinë:

- 1.1. Teksti i thirrjes publike
- 1.2. Udhëzimet për aplikantët
- 1.3. Formularët e aplikimit sipas Rregullores MF-Nr.04/2017.

Neni 4

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të Komunës së Podujevës <https://kk.rks-gov.net/podujeve/>.

Neni 5

1.Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, do të formohet Komisioni Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.

2.Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.

3.Komisioni Vlerësues punët dhe detyrat do t'i ushtrojnë në përputhje me rregullat parapara me Rregulloren për financimin publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

Neni 6

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Neni 7

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot 02-400/01-0014365/25
Podujevë, datë 10.03.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenet 16 dhe 61 parag.1.2 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, në pajtim me nenin 12 të Rregullores MF – Nr. – 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, në kërkesë nr.prot.02-400/03-0014169/25 të datës 07.03.2025, të Drejtorit të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, Kryetari i Komunës, merr:

VENDIM

PËR SHPALLJEN E THIRRJES PUBLIKE PËR MBËSHTETJE FINANCIARE PUBLIKE OJQ-KLUBET SPORTIVE NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

- 1.Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e Rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
- 2.Mbështetja financiare publike e OJQ-Klubeve sportive në Komunën e Podujevës, në fushën e aktiviteteve sportive ofrohen nga Buxheti i Komunës së Podujevës, kodi ekonomik 21200, në kuadër të programit/nënprogramit 85005.

Neni 2

Mjetet financiare shpërndahen në bazë të thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, sipas vlerësimit dhe përzgjedhjes nga ana e komisionit si dhe dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 3

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II të këtij vendimi përfshinë:
 - 1.1. Teksti i thirrjes publike
 - 1.2. Udhëzimet për aplikantët
 - 1.3. Formularët e aplikimit sipas Rregullores MF-Nr.04/2017.
2. Formularët e aplikimit referuar në paragrafin 1 të këtij neni janë:
 - 2.1. Forma e përshkrimit të programit apo projektit
 - 2.2. Forma e buxhetit të programit apo projektit
 - 2.3. Forma e deklarimit të mungesës së fondeve të dyfishta
 - 2.4. Deklarata e Partneritetit

Neni 4

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të Komunës së Podujevës <https://kk.rks-gov.net/podujeve/>.

Neni 5

1. Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, do të formohet Komisioni Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.

2. Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.

3. Komisioni Vlerësues punët dhe detyrat do t'i ushtrojnë në përputhje me rregullat e parapara me Rregulloren për financimin publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

Neni 6

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Neni 7

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. prot 02-400/01-0014367/25
Podujevë, datë 10.03.2025





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 14.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 dhe nenin 21.1 të Rregullores MF-nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, nxjerr:

V E N D I M **PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E PASURISË JO** **FINANCIARE TË KOMUNËS**

Neni 1

Ngritet Komisioni për vlerësimin e pasurisë jo financiare të Komunës, në përbërje:

Albert Ajvazi	kryesues
Haxhere Ajvazi	anëtar
Lutfi Kastrati	anëtar
Rrahim Berisha	anëtar
Arben Neziri	anëtar

Mandati i komisionit është dy vite.

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë të përcaktuara me Rregulloren MF- nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore.

Neni 3

Për punën e kryer Komisioni i paraqet raport Kryetarit të Komunës, përmes Drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, ndërsa shfuqizohet Vendimi nr. prot.02-020/04-0017854/24, datë 14.03.2024.

U dërgohet:

Anëtarëve të komisionit
Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave
QSHQ/Arkivit

Nr. prot. 02-020/04-0014567/25
Podujevë, datë: 10.03.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L – 040, nenet 16 dhe 61 parag. 1.2 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18 dhe nenet 3 parag. 3 dhe 27 paragrafi 1.14 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr. 01-016/01-0030667/22, në kërkesë/rekomandim të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit nr.02-052/09-0014584/25, datë 11.03.2024, merr:

VENDIM PËR LEJIMIN E MJETEVE FINANCIARE

Neni 1

Lejohen mjete financiare në shumë të përgjithshme 1250 € për aktivitetet n'kuadër të Takimeve të Kulturës “Kadri Kadriu” të mbajtura më 20.12.2024, sipas konkursit letrar për poezi, ese dhe tregime të shkurtra datë 21.11.2024, të organizuar nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit-Komuna e Podujevës.

Neni 2

Mjetet financiare sipas nenit 1 të këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe destinohen për prëzgjedhurit/përfituesit sipas Listës përfituese si pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 3

Zbatimin e vendimit e bëjnë Drejtoria e Buxhetit dhe Financave dhe Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit të cilat obligohen për zbatimin e procedurave përkatëse ligjore sa i përket shpenzimit të parasë publike.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot. 02-400/03-0014745/25
Podujevë, datë: 11.03.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-02/01-0050862/18, nenet 8, 11.1 dhe 22 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, Vendimin nr.prot.01-401/01-0065086/24, të datës 26.09.2024, Për Miratimin e Projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2025 dhe Parashikimet Buxhetore 2026-2027, në implementimin e projektit "Përkrahje me Fidane të Mjedrës", në rekomandim të Komisionit Ad-Hoc të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0009788/25 të datës 12.02.2025, për shqyrtimin edhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve sipas Ftesës Publike nr.12-320/01-0004429/25, të datës 21.01.2025, Kryetari i Komunës, merr:

V E N D I M

Neni 1

1. Lejohen mjete financiare për subvencionimin e dhjetë (10) fermerëve përfitues të Komunës së Podujevës për kultivimin e mjedrës.

2. Mbështetja e fermerëve do të bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në ftesën publike për aplikim në projektin "Përkrahje me Fidane të Mjedrës", në shumë të përgjithshme njëmbëdhjetëmijë euro (11,000.00€) për dhjetë (10) fermerët përfitues përkatësisht në vlerën prej 1,100.00 € si vlerë e mbështetjes për një (1) fermer/e.

Neni 2

Qëllim i realizimit të këtij projekti është promovimi dhe zhvillimi i bujqësisë në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 3

Lista e aplikuesve të përzgjedhur për implementimin e projektit: "Përkrahje me Fidane të Mjedrës", sipas nenit 1 është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e Vendimit kujdeset Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, i cili do të bëjë verifikimin, konstatimin dhe vlerësimin e përmbushjes së kushteve dhe kriterëve nga ana e fermerit/es si dhe çështjeve tjera të parapara sipas ftesës publike përkatëse.


Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. prot 02-400/01-0014916/25
Podujevë, datë 12.03.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-02/01-0050862/18, nenet 3 parag.3, 8 dhe 15 parag. 1.1 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, Vendimin nr.prot.01-401/01-0065086/24, datë 26.09.2024, për miratimin e Projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2025 dhe Parashikimet Buxhetore 2026-2027, sipas Konkursit për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Podujevës për vitin akademik 2024-2025 të Drejtorisë së Arsimit n. 05/22, datë 23.01.2025, në rekomandim të Komisionit Ad-Hoc datë 18.02.2025, të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot. 02-020/04-0010641/25, për shqyrtimin edhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të bursave, merr:

VENDIM PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTË

Neni 1

Treqind e nëntëdhjetë e katër (394) studentëve të Komunës së Podujevës, të cilët vijnë studimet në Fakultete të Universiteteve Publike në Republikën e Kosovës, u ndahen bursë në shumë 300 € për secilin student (shuma e përgjithshme 118,200 €), për vitin akademik 2024-2025.

Neni 2

Shuma e mjeteve individuale nuk tejkalon shumën e mjeteve financiare sipas Rregullores për kushtet dhe kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Arsimit.

Neni 3

Pjesë përbërëse e Vendimit është Lista përfundimtare e përfituesve të bursave nr. 05/100, datë 12.03.2025.

Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Arsimit.

Nr.Prot: 02-400/01-0015115/25
Podujevë, datë, 14.03.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L- 040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 22 paragrafi 1 pika 1 të Rregullores për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0014132/25 datë 07.03.2025, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot.02-400/04-0013730/25 të datës 05.03.2025, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

[Redacted] fermer nga fshati Godishnjak, Komuna e Podujevës, mbështetet me mjete financiare në shumë 3,500.00€, për blerjen e materialit ndërtimor për ndërtimin e stallës për bagëti.

Neni 2

Mbështetja financiare bëhet për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike dhe ka për qëllim promovimin dhe zhvillimin e blegtorisë në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 3

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e të përmendurit.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:
Drejtoria përkatëse.
QSHQ/Arkivit

[Redacted] oftohet përmes DBPZHR-së).

Nr.prot 02-400/01-0015258/25
Podujevë, datë, 14.03.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenet 14 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, merr:

V E N D I M

Neni 1

z.Mahmut Ajvazi, zyrtar për ndërtimtari në Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, krahas punëve dhe detyrave nga pozita që mban autorizohet për kryerjen punëve dhe detyrave nga kompetencat dhe përgjegjësitë e inspektorit të ndërtimit në kuadër të Drejtorisë së Inspeksionit në Komunën e Podujevës.

Neni 2

Autorizimi sipas këtij vendimi lëshohet me qëllim të mbulimit të pozitës së inspektorit të ndërtimit dhe i njëjti vlen deri në rekrutimin e zyrtarit/es në pozitën e cekur konform rregullativës ligjore, apo deri në një akt tjetër administrativ, por jo më gjatë se tre (3) muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Neni 3

E përmendura deponon nënshkrimin për vulosjen e dokumentacionit nga fushë veprimtaria e pozitës së cekur.

Nënshkrimi i të autorizuarit _____

Neni 4

Për zbatimin e vendimit kujdesen Drejtoria e Inspeksionit, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit si dhe Zyra e Personelit.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Me këtë vendim njoftohen:

I Autorizuari

Drejtoria e Inspeksionit

Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit


Zyra e Personelit

QSHQ/Arkiva

Nr.prot. 02-016/01-0015113/25
Podujevë, datë: 14.03.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenet 14 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, merr:

V E N D I M

Neni 1

znj.Blerina Zeka, zyrtare për ndërtimtari në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, krahas punëve dhe detyrave nga pozita që mban autorizohet për kryerjen punëve dhe detyrave nga kompetencat dhe përgjegjësitë e inspektorit të ndërtimit në kuadër të Drejtorisë së Inspeksionit në Komunën e Podujevës.

Neni 2

Autorizimi sipas këtij vendimi lëshohet me qëllim të mbulimit të pozitës së inspektorit të ndërtimit dhe i njëjti vlen deri në rekrutimin e zyrtarit/es në pozitën e cekur konform rregullativës ligjore, apo deri në një akt tjetër administrativ, por jo më gjatë se tre (3) muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Neni 3

E përmendura deponon nënshkrimin për vulosjen e dokumentacionit nga fushë veprimtaria e pozitës së cekur.

Nënshkrimi i të autorizuarës _____

Neni 4

Për zbatimin e vendimit kujdesen Drejtoria e Inspeksionit, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit si dhe Zyra e Personelit.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Me këtë vendim njoftohen:

E Autorizuara

Drejtorja e Inspeksionit

Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit

Zyra e Personelit

QSHQ/Arkiva


Nr.prot. 02-016/01-0015114/25
Podujevë, datë: 14.03.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Buliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L- 040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 26 paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 dhe 3.2, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0014132/25 datë 07.03.2025, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot.06-400/04-0015274/25 të datës 14.03.2025, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

Z nga fshati Letanc, Komuna e Podujevës për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore dhe në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve mjekësore i jepet ndihmë financiare në shumë 500.00€.

Neni 2

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e të përmendurit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorive përkatëse.

QSHO/Arkiv

(njoftohet përmes DSHMS-së).

Nr.prot 02-400/01-0015903/25
Podujevë, datë, 20.03.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 17 shkronja (g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Ligjin nr. 04/L-027 për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera dhe Rregulloren (QRK) nr. 17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, si dhe nenet 14 dhe 19 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, merr:

VENDIM

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT NR. PROT. 02-020/04-0001120/25 DATË 08.01.2025

Neni 1

Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi nr.prot. 02-020/04-0001120/25, datë 08.01.2025 për themelimin e Komisionit lokal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Podujevës, si vijon:

Në vend të Vahide Veseli, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit dhe pamundësisë së pjesëmarrjes në punën e komisionit për arsye të shkuarjes në pushim vjetor deri në ditën e pensionimit, anëtare e Komisionit caktohet,

Bleona Musolli, zyrtare në Drejtorinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 2

Vendimi është pjesë përbërëse e Vendimit bazë të përshkruar në nenin 1.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet :
Të caktuarës dhe Anëtarëve të Komisionit (Përmes Kryesuesit)
Zyrës së Personelit
QSHQ/Arkivit*

Nr. prot. 02-020/01-0016119/25
Podujevë, datë: 21.03.2025

Kryetari i Komunës
Shpëtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 26 paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 dhe 3.2, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0014132/25 datë 07.03.2025, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot.02-400/04-0015609/25 të datës 18.03.2025, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

[Redacted], nga fshati Llugë, Komuna e Podujevës për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore dhe në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve mjekësore i jepet ndihmë financiare në shumë 800.00€.

Neni 2

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e të përmendurit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:
Drejtoreve përkatëse.
QSHQ/Arkivit.

[Redacted] njoftohet përmes DSHMS-së).

Nr.prot 02-400/04-0046249/25
Podujevë, datë, 24.03.2025

Kryetar i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-02/01-0050862/18, nenet 3 parag.3, 8 dhe 15 parag. 1.1 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, Vendimin nr.prot.01-401/01-0065086/24, datë 26.09.2024, për miratimin e Projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2025 dhe Parashikimet Buxhetore 2026-2027, sipas Konkursit për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Podujevës për vitin akademik 2024-2025 të Drejtorisë së Arsimit n. 05/22, datë 23.01.2025, pas shqyrtimit të ankesave nga Komisioni i DKA-së nr. prot. 05-117, datë 27.03.2025 dhe në rekomandim të Komisionit Ad-Hoc datë 27.03.2025, të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot. 02-020/04-0010641/25, për shqyrtimin edhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të bursave, merr:

VENDIM PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTË

Neni 1

Katër (4) studentëve të Komunës së Podujevës, të cilët vijnë studimet në Fakultete të Universiteteve Publike në Republikën e Kosovës, u ndahet bursë në shumë 300 € për secilin student (shuma e përgjithshme 1200 €), për vitin akademik 2024-2025.

Neni 2

Shuma e mjeteve individuale nuk tejkalon shumën e mjeteve financiare sipas Rregullores për kushtet dhe kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Arsimit.

Neni 3

Pjesë përbërëse e Vendimit është Lista e Komisionit për ndarjen e bursave nr. 05/118, datë 27.03.2025.

Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Arsimit.


Nr.Prot: 02-67061-0017277/25
Podujevë, datë, 27.03.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 7.1 të Ligjit për Vetqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 11.1 të Ligjit për Vula në Institucionet e Republikës së Kosovës, nr. 03/L-054, Udhëzimin Administrativ Nr. 03/2009 – MSHP për formën e vulës katrore si dhe llojin, nuancat dhe parametrat teknik të ngjyrës së vulës katrore, nenin 7 parag. 7 të Statutit të Komunës, nr. 01-020/01-0050862/18 , në kërkesë të Drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, datë 28.03.2025, merr:

VENDIM PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËR ZHVILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PAJISJE ME VULË KATRORE

Neni 1

Ngritet Komisioni për zhvillimin e procedurave për pajisje me vulë katrore për Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit të Komunës së Podujevës, në këtë përbërje:

Enis Sheholli, kryesues
Artiola Zeneli anëtare
Rafet Hasani anëtar

Neni 2

Komisioni zhvillon procedurat për pajisje me vulë katrore konform Ligjit për Vula në Institucionet e Republikës së Kosovës dhe aktet përkatëse nënligjore në fuqi.

Neni 3

Komisioni për punën e kryer informon Kryetarin e Komunës, përmes Drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit-DPUMM.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:
Anëtarëve të Komisionit
DPUMM
Zyrës së Personelit
QSHQ/Arkiv

Nr. prot. 02-020/04-0017526/25
Podujevë, datë: 28.03.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi

